

Data 05.08.2021

AKTUALIZIM Fletëpalosje për rregulloren e re për hyrjen në Gjermani

Të dashur prindër,

përpara udhëtimeve të planifikuara për pushime ne ju informojmë me anë të kësaj fletëpalosje rreth rregullave të reja në lidhje me kërkesat e hyrjes në Gjermani nga jashtë. Rregullorja e re e hyrjes gjatë koronavirusit është përshtatur në mbarë vendin në mënyrë që nga data **1 gusht 2021** të rregullojë regjistrimin, verifikimin dhe detyrimin e karantines për të gjithë qytetarët që kthehen në Gjermani. Rregullat zbatohen për **zonat jo me rrezik, me rrezik të lartë ose zona me variante të virusit**. Zonat me rrezik „të thjeshtë“ përjashtohen.

Këto duhet të keni parasysh kur hyni në Gjermani:

E re: Zonë jo me rrezik	Zonë me rrezik të lartë	Zonë me variante të virusit
Detyrim për test dhe provë		
<p>Që nga 1 gushti 2021, të gjithë të kthyerit në Gjermani, pavarësisht nga lloji i mjetit të transportit dhe pavarësisht nëse kthehen nga një zonë pa rrezik, me rrezik të lartë apo me variante të virusit, duhet të jenë në gjendje të paraqesin një provë në momentin kur hynë në Gjermani.</p> <p>Si provë vlen: Një rezultat negativ i testit ose një dëshmi e vaksinimit (këtu vlen një vaksinim i plotë, kjo do të thotë të kenë kaluar të paktën 14 ditë nga vakcina e fundit e nevojshme) ose një dëshmi që je shëruar (Test-PCR, i cili të jetë bërë të paktën 28 ditë deri në maksimumi 6 muaj para). Informacionet mbi kërkesat për testet dhe se cila teste njihen, mund të gjenden në RKI: www.rki.de/DE/Content/InfAZ/N/Neuartiges_Coronavirus/Tests.html</p> <p>Kujdes: Fëmijët nën moshën 12 vjeç përjashtohen nga detyrimi për të siguruar provë, por jo nga detyrimi i karantinës kur hyni nga një zonë me rrezik të lartë ose me variante të virusit.</p>		
 Regeln		

Adresa postare
KiTa Bremen
Auf der Muggenburg 5
28217 Bremen

Telefon
0421-361 5700
Telefax
0421-361 59771
E-Mail
office@kita.bremen.de
Internet
www.kita.bremen.de

Tram
Linja 3,5
Stacioni
Eduard-Schopf-Allee

Këto duhen pasur parasysh kur hyni nga një zonë me rrezik të lartë ose nga një zonë me variante të virusit:

Zonë me rrezik të lartë	Zonë me variante të virusit
Listat aktuale të llojeve të zonave të rrezikut mund të gjenden në faqen e internetit të Institutit Robert Koch (RKI): www.rki.de/covid-19-risikogebiete. Klasifikimi i këtyre zonave përditësohet vazhdimisht.	
Detyrim regjistrimi	
<p>Para hyrjes në vend kërkohet një regjistrim dixhital i hyrjes në www.einreiseanmeldung.de (disa-gjuhësh). Kjo vlen nëse keni hyrë në zonën e rrezikut deri në 10 ditë para.</p>	
Detyrim për test dhe provë	
<p>Një test para hyrjes është i detyrueshëm nëse nuk keni një dëshmi të vaksinimit ose shërimit.</p>	<p>Kudjes: Këtu një test para hyrjes është i detyrueshëm pavarësisht vaksinimit apo shërimit.</p>

KiTa Bremen
Në pronësi të komunës Bremen
Menaxher
Wolfgang Bahlmann
Zv. Menaxhere
Petra Zschüntzsch

Deutsche Bundesbank
Filiali Hannover
IBAN
DE09 2500 0000
0025 1015 66
BIC
MARKDEF1250

Numri i taksës
60-100-07915

USt-IdNr.
DE322325940

Zonë me rrezik të lartë	Zonë me variante të virusit
Detyrim karantine	
Në qoftë se keni qenë në një zonë me rrezik të lartë ose me variante të virusit, duhet të futeni në karantinë pas mbërritjes.	
Ju duhet të futeni 10 ditë në karantinë.	Ju duhet të futeni 14 ditë në karantinë.
Rregullat dhe shkurtimi i karantinës	
Nuk ka karantinë për personat plotësisht të vaksinuar ose të shëruar. Karantina mund të përfundojë para afatit që nga koha e transmetimit përmes portalit të hyrjes www.einreiseanmeldung.de . Kujdes: Pavarësisht detyrimit për test para hyrjes, një përfundim i karantinës para afatit është i mundur të paktën 5 ditë pas hyrjes . Deri atëherë karantina duhet respektuar. Kujdes: Për fëmijët nën 12 vjeç, karantina përfundon automatikisht pa detyrim për test 5 ditë pas hyrjes (dita e hyrjes nuk llogaritet).	Karantina nuk mund të përfundojë para afatit. Edhe personat e shëruar, plotësisht të vaksinuar dhe të testar duhet të qëndrojnë 14 ditë në karantinë. Kujdes: Karantina vlen edhe për fëmijët nën 12 vjeç.
Në qoftë se zona e prekur nga varianti i virusit, gjatë kohës së karantinës në Gjermani do të listohet si një zonë me rrezik të lartë, deri në fund të karantinës do të zbatohen rregullat për zonën me rrezik të lartë.	
Karantina përfundon menjëherë, kur zona e prekur me rrezik, pas hyrjes dhe para afatit të përfundimit të karantinës, nuk është më e listuar në www.rki.de/risikogebiete . Ky është rasti kur zona e prekur nuk klasifikohet më as si zonë me rrezik të lartë dhe as si zonë me variante të virusit.	
Në qoftë se simptomat e koronës shfaqen brenda periudhës së karantinës pas hyrjes, ju jeni të detyruar të informoni departamentin e shëndetësisë si dhe të kontaktoni mjekun.	

Përrjashtimet nga detyrimi i karantinës rregullohet nga Rregullorja Hyrëse për Koronën sipas §6. Rregulloren mund ta gjeni në www.bundesgesundheitsministerium.de/coronavirus-infos-reisende. Informacionet për hyrjen janë të disponueshme gjithashtu edhe në gjuhë të ndryshme (www.bundesgesundheitsministerium.de/coronavirus-infos-reisende/einreise-sms-sprachen.html).

Informacione të tjera rreth detyrimit për provë si dhe përjashtimet nga kjo i gjeni te pyetjet dhe përgjigjet në: www.bundesgesundheitsministerium.de/coronavirus-infos-reisende/faq-neue-einreisevo.html si dhe www.gesundheitsamt.bremen.de. Ju gjithashtu mund të telefononi direkt Ministrinë Federale të Shëndetësisë në numrin e telefonit 030-346 46 51000.

Ne ju kërkojmë të konfirmoni me firmën tuaj se ju i keni marrë parasysh dispozitat e mësipërme.

Prindërit/kujdestari ligjor

Fletëpalosja është marrë parasysh

KiTa Bremen
Qendra për fëmijët dhe
Familjet në Bremen

Adresa postare
KiTa Bremen
Auf der Muggenburg 5
28217 Bremen

Telefon
0421-361 5700
Telefax
0421-361 59771
E-Mail
office@kita.bremen.de
Internet
www.kita.bremen.de

Mbiemri, Emri

Data, Firma (kujdesatri ligjor)

Shumë faleminderit për mbështetjen. Ju urojmë gjithë të mirat. Qëndroni të shëndetshëm.

[Übersetzt ins Albanische]

Statusi 05.08.2021